

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sikaflex® Construction+

IZOLUES PËR BETON DHE FASADA MURI



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikaflex® Construction+ është izolues elastik fugash, me 1 përbërës që thahet me lagështinë.

### PËRDORIMET

Sikaflex® Construction+ është krijuar për fuga lëvizjeje dhe lidhjeje në fasadat e betonit.

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë shumë e mirë ndaj kushteve të motit
- Aftësi lëvizshmërie  $\pm 35$  (ASTM C 719)
- Tharje pa flluska
- Punueshmëri e mirë
- Ndërkapje e mirë mbi shumë nënshtresa
- Pa tretës
- Çlirime shumë të ulëta

### INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- EMICODE EC1<sup>PLUS</sup> R
- LEED v2009 IEQc 4.1: Materiale me çlirime të ulëta - Adezivë dhe izolues

### MIRATIME / STANDARDE

- EN 15651-1 F EXT-INT CC 25 HM
- ISO 11600 F 25 HM
- ASTM C 920 kategoria 35

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Poliuretan i teknologjisë <i>i-Cure</i> ®
Ambalazhi	sallam 600 ml, 20 copë/ kuti
Ngjyra	E bardhë, gri betoni
Jetëgjatësia	Sikaflex® Construction+ ka një jetëgjatësi prej 15 muajsh nga data e prodhimit, nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur dhe nëse plotësohen kushtet e magazinimit.
Kushtet e magazinimit	Sikaflex® Construction+ duhet të ruhet në kushte të thata, i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe në temperatura midis +5°C dhe +25°C.
Dendësia	~ 1.45 kg/l (ISO 1183-1)

## TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~28 (pas 28 ditësh)	(ISO 868)
Moduli i shformimit elastik	~0.45 N/mm <sup>2</sup> në 100 % zgjatim (+23 °C) ~1.10 N/mm <sup>2</sup> në 100 % zgjatim (-20 °C)	(ISO 8339)
Zgjatimi deri në thyerje	~800 %	(ISO 37)
Risjellja elastike	~90 %	(ISO 7389)
Rezistenca ndaj përhapjes së grisjes	~7.0 N/mm	(ISO 34)
Aftësia për lëvizje	± 25 % ±35 %	(ISO 9047) (ASTM C 719)
Rezistenca ndaj vjetrimimit nga tensioni mjedisor	8	(ISO / DIS 19862)
Temperatura e funksionimit	-40 °C deri në +70 °C	

### Projektimi i fugës

Gjerësia e fugës duhet të projektohet që të përshtatet me lëvizshmërinë e kërkuar të fugës dhe aftësisë së izoluesit për lëvizshmëri. Gjerësia e fugës duhet të jetë  $\geq 10$  mm dhe  $\leq 50$  mm. Duhet të ruhet një raport thellësie prej 2:1 (për përjashtimet, shihni tabelën më poshtë).

### Gjerësitë standarde të fugave për fuga ndërmjet elementeve të betonit

Gjatësia e fugës [m]	Gjerësia minimale e fugës [mm]	Thellësia minimale e fugës [mm]
2	10	10
4	15	10
6	20	10
8	30	15
10	35	17

Të gjitha fugat duhet të projektohen dhe të dimensionohen në përputhje me standardet përkatëse, përpara krijimit të tyre. Baza për llogaritjen e gjerësive të nevojshme të fugave është lloji i strukturës dhe përmasat e saj, vlerat teknike të materialeve të bashkëngjitura të ndërtimit dhe materiali i izolimit të fugave, si dhe gjithashtu ekspozimi specifik i ndërtesës dhe fugave.

Për fuga më të gjera, ju lutemi kontaktoni me departamentin tonë të shërbimit teknik.

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Gjatësia e fugës [m] për sallam 600 ml	Gjerësia e fugës [mm]	Thellësia e fugës [mm]
	6	10	10
	4	15	10
	3	20	10
	2	25	12
	1.3	30	15

Material mbështetjeje	Përdorni kordona prej shkume polietileni.	
Rrjedha e varjes	0 mm (profil 20 mm, 50 °C)	(ISO 7390)
Temperatura e mjedisit	+5 °C deri në +40 °C, min. 3 °C mbi temperaturën e pikës së vesës	
Temperatura e nënshtresës	+5 °C deri në +40 °C	
Ritmi i maturimit	~3 mm/24 orë (23 °C / 50 % lagështi relative)	(CQP 049-2)
Koha e krijimit të kores	~65 minuta (23 °C / 50 % lagështi relative)	(CQP 019-1)
Koha e përpunimit mekanik	~55 minuta (23 °C / 50 % lagështi relative)	(CQP 019-2)

## UDHËZIME APLIKIMI

### PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë, e qëndrueshme dhe homogjene, pa vajra, graso, pluhur dhe grimca apo materiale të lira. Sikaflex® Construction+ ndërkapet pa prajmer dhe/ose aktivizues. Megjithatë, për ndërkapje optimale dhe aplikime kritike me performancë të lartë, si p.sh. ndërtesat shumëkatëshe, fuga me sforcim të lartë, ekspozim në kushte ekstreme moti apo prani të përhershme uji, duhet të ndiqen procedurat e mëposhtme të lysterjes me prajmer dhe/ose trajtimit paraprak:

#### Nënshtresa joporoze

Alumini, alumini i anodizuar, çeliku i pandryshkshëm, çeliku i galvanizuar, metale të veshura me pluhur apo pllakat me glazurë duhet të pastrohen dhe të trajtohen paraprakisht duke përdorur Sika® Aktivator-205 mbi një pecetë të pastër. Përpara izolimit, lini kohë tharjeje prej > 15 minutash (< 6 orë).

Metale të tjera si bakri, bronzi dhe titanium-zinku, duhet të pastrohen dhe të trajtohen paraprakisht me Sika® Aktivator-205 mbi një pecetë të pastër. Pas kohës së nevojshme të tharjes, përdorni një furçë për të aplikuar Sika® Primer-3 N dhe lini kohë shtesë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë) përpara izolimit të fugave.

PVC duhet të pastrohet dhe të trajtohet paraprakisht me Sika® Primer-215 të aplikuar me një furçë. Përpara izolimit, lini kohë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë).

#### Nënshtresa poroze

Betoni, aerobetoni dhe suvatë me bazë çimentoje, llaçet dhe tullat duhet të lyhen me prajmerin Sika® Primer-3 N duke përdorur një furçë. Përpara izolimit, lini kohë tharjeje prej > 30 minutash (< 8 orë). Shënim: Prajmerat përforcojnë ndërkapjen. Ato nuk zëvendësojnë pastrimin e duhur të nënshtresës dhe as nuk përmirësojnë ndjeshëm rezistencën e sipërfaqes. Për këshilla dhe udhëzime të detajuara ju lutemi kontaktoni me departamentin e shërbimit teknik.

### METODA E APLIKIMIT / MJETET

Sikaflex® Construction+ është gati për përdorim. Pas përgatitjes së përshtatshme të fugës dhe nënshtresës, futni kordonin e mbështetjes në thellësinë e kërkuar dhe aplikoni prajmerin nëse nevojitet. Futni sallamin / tubetën në pistoletë dhe nxirrni Sikaflex® Construction+ brenda fugës, duke u siguruar se izoluesi është në kontakt të plotë me anët e saj dhe shmangni bllokimin e ajrit. Sikaflex® Construction+ duhet të shtypet fort kundrejt anëve të fugës që të sigurohet ndërkapje e mirë. Rekomandohet përdorimi i shiritave atje ku kërkohen vija të sakta fugash ose vija të drejta. Hiqni shiritin brenda kohës së krijimit të kores. Përdorni një agjent kompatibël për përpunimin mekanik (p.sh. Sika® Tooling Agent N) të sipërfaqeve të fugave. Mos përdorni produkte që përmbajnë tretës. Nëse Sikaflex® Construction+ përpunohet mekanikisht kur është i tharë, ka një paraqitje lehtësisht të strukturuar, si betoni. Ndërsa, nëse përpunohet mekanikisht kur është i patharë (duke përdorur p.sh një agjent si Sika®

Tooling Agent N), atëherë sipërfaqja përfundimtare do të jetë e lemuar.

Mos përdorni produkte që përmbajnë tretës si produkte për lëmime!

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me Sika® Remover-208 dhe/ose Sika® TopClean T. Materiali i mbetur mund të hiqet mekanikisht vetëm pas tharjes.

### DOKUMENTA SHITESË

- Material Data Sheet (SDS)
- Tabela e trajtimit paraprak për izolim dhe ngjitje
- Method Statement për izolimin e fugave
- Method Statement për mirëmbajtjen, pastrimin dhe restaurimin e fugave
- Manual teknik për izolimin e fasadave

### KUFIZIME

- Sikaflex® Construction+ mund të lyhet me sistemet e zakonshme për lysterje të fasadave. Megjithatë, bojërat duhet të testohen fillimisht për të siguruar kompatibilitetin duke kryer prova paraprake (p.sh. sipas fletës teknike ISO: Mundësia për lysterje dhe kompatibiliteti i izoluesve me bojërat). Përftohen rezultate më të mira lysterjeje kur izoluesi është i tharë. Shënim: sistemet jo fleksibël të lysterjes mund të dëmtojnë elasticitetin e izoluesit dhe sjellin plasaritje të veshjes me bojë.
- Mund të ndodhë ndryshim i ngjyrës për shkak të ekspozimit ndaj kimikateve, temperaturave të larta, rrezatimit ultraviolet (kryesisht në nuancën e bardhë). Megjithatë, ndryshimi i ngjyrës është tërësisht i natyrës estetike dhe nuk ndikon negativisht tek performanca teknike apo rezistenca e produktit.
- Mos përdorni Sikaflex® Construction+ mbi gurin natyror.
- Mos përdorni Sikaflex® Construction+ mbi nënshtresa çimentoje, gomë natyrore, gomë EPDM ose mbi materiale ndërtimi prej të cilave mund të rrjedhin vajra, plastifikatorë apo tretës të cilët mund të sulmojnë izoluesin.
- Mos përdorni Sikaflex® Construction+ për të izoluar fuga brenda dhe përreth pishinave.
- Mos përdorni Sikaflex® Construction+ për fuga nën presion uji ose në prani të përhershme uji.
- Mos ekspozoni Sikaflex® Construction+ e patharë ndaj produkteve me përmbajtje alkooli, pasi kjo gjë do të ndikojë në reaksionin e tharjes.

### BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sikaflex® Construction+  
Qershor 2019, Botimi 02.01  
020511010000000028

SikaflexConstruction+-sq-AL-(06-2019)-2-1.pdf